



Datë: 15.04.2026

Numër Protokolli: 1966/2026

A.nr.1892/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1892/2025, të datës 10.11.2025, të parashtruar nga ankuesi G.Z, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*transferim sipas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1892/2025, e datës 10.11.2025, e parashtruar nga ankuesi G.Z.

II. Anulohet Vendimi Nr.R.MBPZhR 8622025, i datës 31.10.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe pjesa/pika II, numër rendor 100 e Raportit më numër protokolli 3412 të datës 30.10.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.

III. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit, të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i themeluar sipas Vendimit V.nr. 1478/2025, të datës 04.07.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të rishqyrtoj çështjen e ankuesit, në atë mënyrë që sistemimi i ankuesit si rezultat i ristrukturimit të jetë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil G.Z (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 10.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr. R.MBPZhR 8622025, të datës 31.10.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me transferimin e saj për shkak të ristrukturimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZhR), ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7250/2025, të datës 10.11.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 13.11.2025; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, me numër protokolli Nr.2037, të datës 31.10.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit G.Z; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 10.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 25.11.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Akt emërimi i G.Z me numër protokolli Nr.4498 të datës 04.12.2024; Kërkesë për shpalljen e dy pozitave për DAESB, me numër protokolli Nr.3109, të datës 15.08.2024; Konkursi me numër reference RN00014892, i datës 21.08.2024; Formulari i përshkrimit të punës; Listë e pagave e datës 04.12.2024 deri më datë 30.11.2025; Vendim për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit, me numër protokolli Nr.1478, të datës 04.07.2025; Raporti përfundimtar me rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit për MBPZHR, me numër protokolli Nr.3412, i datës 30.10.2025; Rregullore (ZKM)Nr.01/2025 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Rregullore (QRK)Nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; E-mail i datës 14.04.2026;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe së çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, *sepse*:

I. Gjendja e Çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 11/2024 të datës 04.12.2024, është emëruar në pozitën Zyrtar i Lartë për Analiza Agro-Ekonomike, në Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në MBPZhR, më klasë të pozitës Profesional 1.

- Kryeministri i Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr.226/ 2025, të datës 05.03.2025, ka miratuar Rregulloren (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër V.nr. 1478/2025, të datës 04.07.2025, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MBPZhR, ku ky i fundit, më datë 30.10.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MBPZhR, ashtu që, ankuesi sipas pikës II.100, është propozuar të transferohet nga pozita Zyrtar i Lartë për Analiza Agro-Ekonomike, Divizioni i Analizave Ekonomik/ Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore, në pozitën Zyrtar i Lartë për Përpunim, Validim dhe Raportim të të Dhënave në Divizionin për Rrjetin e të Dhënave dhe Kontabilitetit në Fermë, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore, më arsyetimin së pozita e tij sipas Rregullore së re Nr.01/2025 është kategorizuar si specialist ndërsa ankuesi ka klasë profesional 1.
- Në zbatim të propozimi të Komisionit të Ristrukturimit, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më Vendimin me Nr.R.MBPZhR 62/2025, të datës 31.10.2025, ka transferuar ankuesin nga pozita Zyrtar i Lartë për Analiza Agro-Ekonomike, Divizioni i Analizave Ekonomik/ Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore në pozitën Zyrtar i Lartë par Përpunim, Validim dhe Raportim të të Dhënave në Divizionin për Rrjetin e të Dhënave dhe Kontabilitetit në Fermë, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr. R.MBPZhR 62/2025, të datës 31.10.202, të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, duke pretenduar së vendimi i kontestuar nuk përmban shpjegim të qartë mbi nevojën institucionale, arsyet organizative apo bazën ligjore që justifikon këtë transferim. Me tej shton së profili i tij si agro ekonomist dhe përvoja e tij e punës nuk përshtatet pozitën në fjalë. Ankuesi pretendon se procesi i ristrukturimit është përcjell me mungesë transparencë dhe konsultimi, sepse, ankues asnjëherë nuk ishte informuar dhe as që i është dhënë mundësi e parashtrimit të mendimit të tij. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të rikthehet në vendin e tij të punës si zyrtar për analiza ekonomike.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankusit lidhur me të drejtën e sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i*

ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës..... dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizimit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës.

Ndërsa, në kuptim të vërtetimit të faktit, nëse pozita e ankuesit ka pësuar ristrukturim, Kolegji ka analizuar Rregulloren Nr.37/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila ka qenë në fuqi deri me datë 14.03.2025, ku sipas nenit 6.5 të kësaj rregullore Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore, ka qenë i organizuar sipas strukturës: Divizioni i Analizave Ekonomike dhe Divizioni për Statistika Bujqësore, ndërsa, sipas Rregullores (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kolegji, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore ka pësuar ndryshim më strukturë organizative ashtu që në kuadër të tij përveç Divizionit për Analiza Ekonomike dhe Divizioni për Statistika Bujqësore, është krijuar edhe një njësi e re gjegjeshit Divizioni për Rrjetin e të Dhënave dhe Kontabilitetit në Fermë, pra, pozita e ankuesit si Zyrtar i Lartë për Analiza Agro-Ekonomike, parashihet edhe me rregullore të re dhe se kjo pozitë është klasifikuar në kategorinë Specialist dhe mbi këtë bazë kanë ndryshuar edhe kriteret formale të përgjithshme.

Rrjedhimisht, sipas përshkrimit të vjetër të detyrave të punës, si kërkesat e përgjithshme formale lidhur me pozitën Zyrtar i lartë për Analiza Agro-ekonomik, klasa profesional 1, kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor): Biologji, Zoologji, Agrokulturë, Hortikulturë, Pylltari, Gjeografi, Fizikë, Kimi, Matematikë, Ekologji, Agronomi, Veterinari, Mjedis. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Ndërsa, sipas përshkrimit të ri të detyrave të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë vendosur: *Diplomë të arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor) Grupi: 30 Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës (Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veterinari). Përvoja: Së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Andaj, referuar bazës ligjore si më sipër dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e sistemimit të ankuesit si pasojë e ristrukturimit, mbi faktin se ankuesi ishte emëruar më datë 04.12.2024 si rezultat i

përzgjedhjes si kandidat fitues sipas konkursit më RN00014892 i shpallur me datë 21.08.2024, dhe se pozita e tij ishte klasifikuar në atë kohë në klasën profesional 1, pasi që Ministria e Bujqësisë më rastin e shpalljes së konkursit në fjalë nuk e kishte të përfunduar procesin e organizmit dhe klasifikimit sipas Rregullores (QRK) Nr.06/2026 për klasifikimin vendeve të punës në shërbim civil, kështu që, me miratimin e Rregullores (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MBPZHR, klasifikimi i pozitës së ankuesit në kategorinë specialist nuk mohon të drejtën e ankuesit për sistemin në pozitën e emëruar sipas procedurës ligjore nën kushtin që ankuesit të plotësoj kriteret formale të përgjithshme.

Në fakt, Kolegji ka analizuar provat e dorëzuara nga ankuesi referuar përgatitjes arsimore ku dhe ka konstatuar së ankuesi ka të përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë Drejtimi Agro Ekonomi, pra, ankuesi posedon kualifikimit arsimor lidhur me pozitën Zyrtar i Lartë për Analiza Agro Ekonomike, kategoria specialist, andaj, edhe në vlerësimin e Kolegjit mos sistemi i ankuesit vetëm mbi shkakun së pozita e tij është klasifikuar si specialist nuk përben shkak ligjor të përjashtimit për transferim në pozitën përkatëse, kështu që, mbi këto rrethana kolegji më qëllim të kthimit të ligjshmërisë, aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi Vendimin Nr.R.MBPZhR 8622025, të datës 31.10.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe pjesën II, pika rendore 100 të Raportit më numër protokolli 3412 të datës 30.10.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni i Ristrukturimit, të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i themeluar sipas Vendimit V.nr. 1478/2025, të datës 04.07.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me detyrimin që të rishqyrtoj çështjen e ristrukturimit të ankuesit duke vepruar në pajtim më pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

Për sa më sipër, e duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1892/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, G.Z;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- MBPZHR: Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së;